

**VENDIM**  
**Nr. 138, datë 18.2.2015**

**PËRDISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 433, DATË 5.5.2010, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE**  
**KOMPETENCAT E BORDIT DREJTUES TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME**  
**TË STANDARDIZIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 9870, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 433, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) 2 (dy) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë;

b) 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për transportin dhe infrastrukturën;

c) 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për bujqësinë.”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**